



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 15/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për apelin e subjektit politik Stranka Demokratska Akcija (SDA) paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të datës 13.02.2014 me nr. 331/2014, për shkak të pezullimit të subjektit politik SDA nga regjistri i subjekteve politike, në seancën e panelit të mbajtur me 21.02.2014, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli i subjektit politik Stranka Demokratska Akcija (SDA), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të datës 13.02.2014 me nr. 331/2014.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 19.02.2014, nëpërmjet të PTK-së ka pranuar një apel të dorëzuar në këtë të fundit me datën 14.02.2014 nga subjekti politik SDA në të cilën theksohet se KQZ me datë 13.02.2014 përshkak të mosmbajtjes së kuvendit zgjedhor në afatin e paraparë me ligj brenda periudhës kohore prej 48 muajve ka marr vendim për suspendimin e subjektit politik SDA si dhe duke i dhënë një afat shtesë prej 45 ditësh për mbajtjen e kuvendit të partisë pas së cilit afat SDA do të fshihet nga regjistri nëse nuk e mban kuvendin e saj në afatin e lartpërmendur. Parashtruesi i apelit kërkon që të ndryshohet vendimi i KQZ-së për suspendim dhe fshirje nga regjistri dhe kërkon që të merret një vendim tjetër për detyrimin e SDA-së për mbajtjen e kuvendit partiak dhe me të cilin vendim SDA do të pranonte obligimin që në një afat prej 45 ditësh më së largu deri me 30.03.2014 do ta mbaj kuvendin e rregullt të SDA-së. Parashtruesi i apelit kërkon që të ketë mirëkuptim për SDA si një parti e cila ka një traditë dhe histori prej rreth 24 vite e cila ka kontribuar shumë për Kosovën e tanishme dhe duke shprehur keqardhje pasi që siç theksohet në apel se nuk kanë qenë e njoftuar me rregullën zgjedhore 01/2013 dhe se si arsye tjetër për mosmbajtjen e kuvendit partiak theksohet harresa e këtyre afateve për të cilin sipas parashtruesit të apelit këto masa të suspendimit nuk kanë ekzistuar në ligjin e mëparshëm

Në vendimin e ankimuar me nr. 331/2014 të datës 13.02.2014 të KQZ-së, është pezulluar subjekti politik Stranka Demokratska Akcija (SDA), për shkak të mos mbajtjes së kuvendit partiak të paraparë në bazë të nenit 15.1 të Rregullës Zgjedhore

01/2013, për regjistrimin dhe Punën e Partive Politike ku SDA, pezullohet nga regjistri i partive politike. Në pikë 2 të vendimit të ankimuar bazuar në nenin 6.1 të Rregullës Zgjedhore 01/2013, SDA pas pranimit të vendimit të ankimuar ka një afat shtesë prej 45 ditëve për ta mbajtur Kuvendin e saj, në të kundërtën do të fshihet nga regjistri i partive politike me arsyetim se subjekti politik SDA nuk i ka plotësuar obligimet të cilat parashihen me nenin 15 paragrafi 1 të Rregullës Zgjedhore nr 01/2013.

PZAP-i, në kuptim të nenit 10 paragrafi 1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi KQZ-në - ZRPPC-në më datën 19.02.2014, për apelin e parashtruar ndaj vendimit të saj dhe kërkoi që të përgjigjet deri me datën 20.02.2014.

KQZ-ja në përgjigjen e saj ndaj apelit të lartpërmendur ka theksuar se ZRPPC i ka rekomanduar KQZ-së për pezullimin e subjektit politik SDA pasi që ky subjekt politik nuk e ka mbajtur kuvendin e saj zgjedhor ashtu siç parashihet me nenin 15.1 të Rregullës Zgjedhore 01/2013 të KQZ-së

PZAP-i, pas administrimit të pretendimeve ankimore, vendimit kontestues të datës 13.02.2014 me numër të protokollit 331-2014 të KQZ-së, përgjigjen në apel të KQZ-ZRPPC-së dhe rekomandimit të saj gjeti se:

Apeli është i pabazuar.

PZAP-i, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka rikualifikuar si apel duke u bazuar në nenin 1 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

PZAP-i, konstaton se KQZ-ja me vendimin me nr. 331/2014 të datës 13.02.2014 ka vendosur drejt me rastin e pezullimit nga regjistri i partive politike për subjektin politik SDA ngase siç vërtetohet edhe nga shkresat e lendes subjekti politik në fjalë nuk i ka përmbushur obligimet ligjore të cilat parashihen me nenin 15 të Rregullës Zgjedhore me numër 01/2013, prandaj edhe nuk qëndrojnë pretendimet e theksuar në apel.

Andaj, bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), të cilin parashihet se: *PZAP-i pranon apelet e bazuara në fakte dhe refuzon apelet të cilat nuk i përmbushin standardet dhe arsyet e cekura më lart, vendosi si në dispozitivë të këtij vendimi.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 15/2014 më datën 21.02.2014.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.